

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR

lvira Tartaraj, sot në datë

26.06.2015, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore kërkesën penale me
Nr. 53101-01021-62-2015(665)Regj. Themeltar, që i përket:

KËRKUES:

**Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor
Fier**, përfaqësuar në gjykim nga prokuror, z.
Clirim Sino.

KUNDËR TË PANDEHURIT: Fredi Alizoti i biri i Elmas dhe i Ildize,
dtl.13.04.1973, lindur dhe banues ne Fier lagjia
Bubulina Raj.1 me shtetesi shqiptare, me gjendje
civile i divorcuar, me arsim 8-vjecar, i denuar me
pare per vjedhje me dhune, me mase sigurimi
arrest ne burg ne gjendje paraburgimi prej dates
06.12.2014 ora 03:00, mbrojtur nga mbrojtësi I
caktuar kryesisht av. Nexhip Dauti.

AKUZUAR :

Për kryerjen e veprës penale të “*Vjedhja*” sipas
paragrafit të parë, të parashikuar nga neni 134/1
i K. Penal

Në përfundim të gjyqimit zhvilluar në prani të përfaqësuesit të Prokurorisë,
si dhe në prani të të pandehurit dhe mbrojtësit të tij, Gjykata, pasi shqyrtoi
në tërësi rrethanat e çështjes dhe çmoi dhe vlerësoi në tërësi provat e marra
në seancë gjyqësore nënshtruar rregullave të gjyqimit dhe dëgjoi në fazën e
konkluzioneve përfundimtare palët, në të cilën u kërkuar:

Prokurori:

1. Deklarimin fajtores te te pandehures **Fredi Alizoti**, per kryerjen e vepres
penale te “**Vjedhjes**” ne rrethane renduesete parashikuar nga neni 134/1

dhe 50 germa “ç” te K.Penal dhe ne baze te ketyre dispozitave denimin e tij me 3 (tre) vjet burgim.

2. Sygjerojme gjykatën që në masën e denimit të aplikoj kërkesat e nenit 406 të K.Pr.Penale duke ulur denimin me 1/3.

3. Shpenzimet procedurale në masën 3.100 leke në ngarkim të të pandehurit **I pandehuri nëpërmjet mbrojtësit të tij**: Jemi përpara veprës penale të “Shkatërimit prone” parashikuar nga eni 150 i K.Penal dhe nëse gjendet fajtor për ndonjë vepër të dënohet me kohën e paraburgimit, pasi ka gjendje të rënduar ekonomike dhe nënën e ka të sëmurë.

V Ë R E N

I. Procedura.

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier ka paraqitur pranë kësaj Gjykate kërkesën për gjykimin e të pandehurit Fredi Alizoti për kryerjen e veprës penale të “Vjedhjes” parashikuar nga neni 134§1 i K. Penal.

Përpara shqyrtimit të akuzës, Gjykata merr kryesisht (*proprio motu*) në shqyrtim faktin nëse ka apo jo juridiksion gjyqësor penal dhe nëse është apo jo kompetente nga pikëpamja e kompetencës lëndore dhe tokësore në shqyrtimin e kësaj çështje.

Juridiksioni gjyqësor penal përcaktohet inter alia në nenin 69 të Kodit të Procedurës Penale. Kjo dispozitë përcakton se: “Juridiksioni penal ushtrohet nga gjykatat penale sipas rregullave të caktuara në këtë Kod”. Bazuar në këtë dispozitë procedurale si dhe duke patur parasysh ndarjen e juridiksionit gjyqësor, në atë civil dhe penal, kjo Gjykatë konstaton se ka juridiksion për shqyrtimin e çështjes penale objekt gjykimi.

Në lidhje me përcaktimin e kompetencës lëndore në shqyrtimin e kësaj çështje, Gjykata referon në nenin 74 të Kodit të Procedurës Penale, ku parashikohet se: “Gjykata e Rrethit Gjyqësor është kompetente për gjykimin e veprave penale, përveç atyre që i përkasin kompetencës së gjykatës për krime të rënda, gjykatës ushtarake dhe Gjykatës së Lartë.” Në interpretim të kësaj dispozite, konkludohet se, ligjëvënësi merr në konsideratë si kriter të vetëm për të identifikuar gjykatën kompetente në lëndë (*ratione materiae*), llojin e veprës penale objekt gjykimi. Sipas kësaj dispozite, vepra penale objekt gjykimi, në interpretimin përjashtues, nuk është në kompetencë lëndore as të gjykatës për krime të rënda, as të gjykatës ushtarake dhe as të Gjykatës së Lartë dhe si rrjedhojë, kjo Gjykatë konstaton se ka kompetencë lëndore për shqyrtimin e çështjes penale objekt gjykimi.

Në përcaktimin e kompetencës lëndore, Gjykata mban parasysh edhe parashikimin e nenit 13/3 të K.Pr.Penale i cili parashikon se: “Gjykatat e rretheve gjyqësore dhe ato ushtarake gjykojnë me një gjyqtar veprat penale, për të cilat parashikohet dënim me gjobë ose me burgim në maksimum jo më shumë se 7 vjet. Veprat e tjera gjykohen me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë”,

të interpretuar konform jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese e cila është shprehur se: “..frazja **“gjykatë ... e caktuar me ligj”** në nenin 42/2 të Kushtetutës mbulon jo vetëm bazën ligjore për vetë ekzistencën e gjykatës, por edhe kompozimin e trupit gjykues të ngarkuar për shqyrtimin e çdo çështje konkrete”. (**shiko Vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 12, datë 18.05.2005; nr. 14, datë 17.04.2007**). Nisur nga parashikimi ligjor i mësipërm, i analizuar në lidhje me kufijtë e dënimit të parashikuara nga neni 291 i K.Penal, Gjykata vlerëson se kjo çështje duhet të gjykohej nga një gjyqtar, duke përmbushur kriterin e një gjykatë të caktuar me ligj. Ndërsa në lidhje me përcaktimin e kompetencës nga pikëpamja tokësore, Gjykata referon në nenin 76 të Kodit të Procedurës Penale. Konkretisht, kjo dispozitë parashikon se: *“Kompetenca tokësore përcaktohet, me rradhë, nga vendi ku është kryer ose është tentuar të kryhet vepra penale ose vendi ku ka ardhur pasoja.”* Në rastin objekt gjykimi, nisur nga fakti se vepra penale rezultoi të jetë kryer në qytetin e Fierit, kjo gjykatë e gjen veten kompetente nga pikëpamja territoriale për gjykimin e kësaj çështje.

Nga aktet e ndodhura në fashikullin e gjykimit rezultoi se i pandehuri është me masë sigurimi “Arrest në burg”. Gjithashtu, rezultoi se i pandehuri ka marrë dënimin rregullisht për të gjitha aktet e hetimeve paraprake duke i nënshkruar personalisht ato dhe duke mos iu fshehur në këtë mënyrë drejtësisë. Pra, rezultoi se ai është njohur paraprakisht me materialet, provat dhe rezultatet e hetimit.

Në fazën procedurale të parashtrimit të kërkesave paraprake në kuptim të nenit 354 të Kodit të Procedurës Penale dhe të kërkesave të tjera përpara fillimit të shqyrtimit gjyqësor, i pandehuri, në bazë të nenit 403 të Kodit të Procedurës Penale kërkoi që të procedohej ndaj tij me gjykim të shkurtuar, duke menduar se çështja mund të zgjidhet në gjendjen që janë aktet.

Në lidhje me kërkesën për gjykim të shkurtuar parashtruar nga i pandehuri nëpërmejt mbrojtësit të tij, Gjykata thekson se në interpretimin literal dhe logjik të nenit 403 të Kodit të Procedurës Penale, ku parashikohet se: *“I pandehuri ose përfaqësuesi i tij i posaçëm mund të kërkojnë që çështja të përfundojë derisa të mos ketë filluar shqyrtimi gjyqësor”*, në harmoni edhe me parimet e përgjithshme mbi të cilat udhëhiqet i gjithë procedimi penal ndaj të pandehurit, Gjykata vlerëson se e drejta për të kërkuar procedimin me gjykim të shkurtuar i rezervohet në rradhë të parë personalisht të pandehurit, por edhe përfaqësuesit të tij të posaçëm. Në këto kushte, meqënëse kërkesa e paraqitur nga mbrojtësi i të pandehurit, u miratua personalisht nga ky i fundit, gjykata e legjitimoi mbrojtësin në paraqitjen e një kërkesë të tillë.

Gjykata, pasi mori edhe mendimin e prokurorit, i cili u shpreh se ishte dakort me kërkesën e të pandehurit për gjykim të shkurtuar dhe pas shqyrtimit me imtësi të të gjitha akteve të ndodhura në fashikullin e gjykimit, ku konstatoi se ato nuk përmbanin ndonjë pavlefshmëri nga ato të parashikuara në nenin

128 të K.Pr.Penale, vlerësoi se bazuar në nenin 404 të Kodit të Procedurës Penale, ka vend për të proceduar me gjykim të shkurtuar.

Duke patur parasysh se procedimi me gjykim të shkurtuar, si një gjykim i posaçëm, eviton fazën e debatit mbi provat, të gjitha aktet e grumbulluara gjatë hetimeve paraprake, u bënë pjesë e fashikullit gjyqësor, duke përjashtuar mundësinë e administrimit të provave të reja. Aktet e depozituara në fashikullin hetimor dhe njëkohësisht atë gjyqësor, shërbyen si bazë për parashtrimin e konkluzioneve përfundimtare nga palët, dhe njëkohësisht si bazë për marrjen e vendimit përfundimtar nga gjykata, duke respektuar në këtë mënyrë kërkesat procedurale të gjykimit të shkurtuar të sanksionuara në Kodin e Procedurës Penale dhe të interpretuara për efekt të unifikimit të praktikës gjyqësore në vendimin Nr. 2, dt 29.01.2003 të Gjykatës së Lartë sipas të cilit: *“Gjykimi i shkurtuar, si gjykim i posaçëm, në thelb te tij ka pranimin e akteve të grumbulluara gjatë fazës së hetimit paraprak dhe eviton marrjen e provave në seancë gjyqësore dhe debatin lidhur me to. Ky gjykim eviton fazën e hetimit gjyqësor ... Me pranimin e kërkesës për të vazhduar me gjykim të shkurtuar, dosja e prokurorit kthehet në dosje gjyqësore dhe shërben për t’u bazuar në parashtrimin e konkluzioneve përfundimtare të palëve dhe për dhënien e vendimit nga gjykata...”*.

II. Faktet dhe provat

Rreth ores 23:50 te dates 05.12.2014, patrulla e policise se Komisariatit Fier, ka shkuar tek lokali Bar Rei i cili ndodhet ne lagjen kryengritja e Fierit perballe QTU per shkak se, dy persona ishin grindur me pronarin e lokalit dhe njeri prej tyre kishte pasur nje send te ngjashem me pistoleten ne brez. Gjate komunikimit me pronaret e lokalit, patrulla e policise eshte njoftuar nga salla operative se tek karburanti GULF i cili ndodhet po ne kete lagje kishin thyer xhamat e lokalit dhe kishin vjedhur televizoret.

Menjehere patrulla e policise eshte nisur ne vendin e informuar dhe tek karburanti GULF kane pare te thyer xhamin e lokalit dhe rreth 100 metra larg lokalit kane konstatuar nje shtetas i cili po largohej me dy televizore ne krah. Menjehere eshte bere kapja e ketij shtetasi sebashku me provat materiale televizoret e vjedhur te markes Telefunken 42 dhe 22 polsh dhe rezulton se autori ishte i pandehuri Fredi Alizoti.

Eshte njoftuar policia gjyqesore per kete ngjarje e cila ka shkuar ne vendngjarje. Gjate kqyrjes se vendit te ngjarjes eshte konstatuar se xhami i fasades se lokalit te karburantit GULF eshte i thyer dhe ka permasat 330cm x 130 cm. Pertoke konstatohen mbejtje balte dhe plehu te ngjashem me ate te vazove te luleve si dhe nje kapak pusete i cili mendohet se ka sherbyer per te thyer xhamin. Ne brendesi te lokalit, konstatohen se tek vendi ku kane qene te montuar televizoret ata mungojne dhe u jane fishat e varura.

Prej oficerit te policise jane kryer hetime dhe verifikime dhe nga deklarimet e dhëna nga specialist i sektorit të rëndit Pajtim Aliaj rezulton se ai ka parë të pandehurin duke u larguar nga vendngjarja me dy televizorët plazma në dorë duke u përpjekur të kalonte një gardh dhe është proceduar me arrestimin e tij.

Me tej kqyrja ka vazhduar ne ambjentet e jashtme dhe konstatohet se nje distance rreth 60 metra larg lokalit midis pallateve dhe ne anen veriore te objektit te shtetasit Mynyr Buzi, konstatohen dy televizore te markes Telefunken nje 42 polsh dhe tjetri 22 polsh, te cilet jane te hedhur permbysh dhe te lagur nga shiu plotesisht.

Nga kqyrja e regjistrit te salles operative te Komisarariatit te Policise Fier, rezulton se, ne oren 23:48 eshte telefonuar nga numri 0694061272 dhe njofton se tek karburanti GULF ne lagjen K/Fierit tek nje lokal Lloto sporti jane dy cuna te cilet po vjedhin televizoret.

Eshte verifikuar numri i telefonit celular si dhe personi qe ka telefonuar dhe ka rezultuar se telefoni celular i perket pikes se karburantit Gulf dhe naten e ngjarjes eshte perdorur nga punonjesi i pikes se karburantit Laert Kociaj dhe ky shtetas, ka deklaruar para oficerit te policise gjyqesore se ka pare nje person qe ka vjedhur televizoret dhe jo dy sic eshte bere shenimi ne librin e salles operative.

Ne baze te aktit te ekspertimit vleresues date 19.01.2015 rezulton se, televizori 42” kap vleren e 79.853 lekeve, televizori 28” kap vleren e 29.038 lekeve, ndersa, demi i shkaktuar nga thyerja e xhamit kap vleren prej 6.864 leke.

Ne keto rrethana, u cmua se, pasoja e ardhur nga vjedhja nuk eshte pasoje e rende pasi nuk kalon vleren e 1.000.000 lekeve, vlere e demit te shkaktuar nga thyerja e xhamit eshte e vogel dhe eshte pasoje e lehte duke vleresuar edhe praktiken gjyqesore por edhe aktivitetin tregtar te personit te demtuar si dhe, autori i veprës penale u provua te jete vetem nje person, i pandehuri Fredi Alizoti.

III-Vlerësimi i Gjykatës.

Përsa i përket cilësimit juridik të veprës penale:

Gjykata vëren se, vepra penale për të cilën akuzohet i pandehuri parashikohet në Kreun III të K.Penal me titull “Vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike”, Seksioni I “Vjedhja e pasurisë”, të cilat kanë si qëllim mbrojtjen e paprekshmërisë së pronës mbi sendet e luajtshme të personave privatë, të personave juridik dhe shtetit, të mbrojtura posaçërisht

nga neni 41 i Kushtetutës, Protokolli 1 i Konventës Evropiane të Drejtave të Njeriut, dhe legjislacionin penal nga veprimet ose mosveprimet kriminale.

Nga interpretimi i nenit 134/1 të K.Penal rezulton se, ligjvënësi ka parashikuar një mbrojtje të posaçme juridike në drejtim të pronës dhe pasurisë, cënimi i të cilës passjell përgjegjësi penale. Këto veprime që kanë sjellë cënimin e pronës, për t'u cilësuar si vepër penale nga ligji, duhet që :

- II. objekt i veprës penale të jetë konkret dhe i vlerësueshëm, në rastin konkret nga aktit te ekspertimit vleresues date 19.01.2015 rezulton se sendet e vjedhura: televizori 42” kap vleren e 79.853 lekeve, televizori 28” kap vleren e 29.038 lekeve, ndersa, demi i shkaktuar nga thyerja e xhamit kap vleren prej 6.864 leke. Ne keto rrethana, u cmua se, pasoja e ardhur nga vjedhja nuk eshte pasoje e rende pasi nuk kalon vleren e 1.000.000 lekeve.
- III. nga ana objektive i pandehuri me veprime aktive, të kundraligjshme të ketë hedhur në dorë në mënyrë të fshehtë ose, të hapur pasurinë e një personi tjetër (*pronarit apo poseduesit*), duke pakësuar në këtë mënyrë pasurinë e këtij të fundit.
- IV. subjekti i veprës penale të ketë qenë mendërisht i përgjegjshëm dhe të ketë mbushur moshën për përgjegjësi penale, në rastin konkret të ketë mbushur 14 vjeç. Nga shqyrtimi gjyqësor rezultoi se i pandehuri është mendërisht i përgjegjshëm dhe ka mbushur moshën penale për përgjegjësi penale.
- V. hedhja në dorë e pasurisë së tjetrit nga i pandehuri, duhet të bëhet me qëllim përfitimi material për vete, apo për persona të tjerë me qëllim për të mos e kthyer më atë. Në rastin konkret u vërtetua se i pandehuri me të gjitha veprimet e kundërligjshme të ndërmarra tregoi vendosmri jo vetëm në përvetësimin e televizorëve por edhe në transportimin e tyre me qëllim përfitimi ekonomik.

Si përfundim, rezultoi e provuar se shtetasi Fredi Alizoti e ka kryer plotësisht figurën e veprës penale “Vjedhja” sipas paragrafit të parë, të parashikuar nga neni 134§1 i K. Penal.

Lidhur me caktimin e llojit dhe masës së dënimit.

Gjykata thekson se, caktimi i llojit dhe i masës së dënimit për shtetasin Fredi Alizoti, duhet të bëhet mbi bazën e individualizimit të këtij dënimi, sipas kriterëve dhe kushteve ligjore të parashikuara në nenin 47 të K. Penal dhe nga jurisprudenca e Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese.

Sa më sipër, Gjykata çmon se duhen mbajtur parasysht këto rrethana :

1. Rrezikshmërinë relativisht të lartë të veprës penale të “Vjedhjes”, për të cilën ligjvënësi ka parashikuar dënim nga gjobë deri në tre vjet burgim.
2. Faktin se, vjedhja e sendeve nëpër ambientet private të shtetasve, ka marrë një përhapje të gjerë.
3. Faktin se, vepra penale është realizuar e plotë kundrejt pasurisë së të dëmtuarit Nolin Ruko.

4. Faktin se, vlera e sendeve të vjedhur është e vogël.
5. I pandehuri ka mbajtur qëndrim mohues ndaj veprës penale fakt i cili ndikon në rritjen e rrezikshmërisë së autorit të veprës penale.
6. Faktin se, sipas vërtetimit të gjendjes gjyqësore nr.1prot, dt.20.01.2014 i pandehuri rezulton i dënuar më parë me vendimin nr. 49, dt. 01.02.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 278/2 dhe 279, gjithashtu me vendimin nr.50, dt. 30.03.2004 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier i pandehuri rezulton të jetë deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale “vjedhjes me dhunë” në bashkëpunim parashikuar nga neni 139 e 50/gj i K.penal. Ky fakt tregon se ai është duke u kthyer në një recidivist të cilësuar, me rrezikshmëri të lartë shoqërore.
7. Faktin se, i pandehuri nuk paraqiti ndonjë provë për të vëretuar se, ka përgjegjësi dhe detyrime themelore ndaj shkollës, familjes apo, karshi të tretëve.
8. Faktin se ka një nivel të ulët arsimor, i cili ndikon negativisht në gjetjen e një pune stabël e për rrjedhim ndikon në rritjen e rrezikshmërisë shoqërore të të pandehurit.

Në këto kushte, bazuar në nenet 47-50 të K.Penal Gjykata vëren se, nisur nga rrethanat e mësipërme, i pandehuri paraqet rrezikshmëri shoqërore të tillë, që e bën të domosdoshëm izolimin e tij nga shoqëria në masën e kërkuar nga prokurori.

Duke qenë se në gjykimin e kësaj çështjeje është proceduar me gjykim të shkurtuar, në zbatim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, i cili parashikon: “1. Kur jep vendim dënimi, gjykata e ul dënimin me burgim ose gjobë me një të tretën...” gjykata vendosi dënimin e të pandehurit me **2 vjet burgim**. Vuajtja e këtij dënimi do të fillojë nga dita e arrestimit të tij më **dt 06.12.2014 ora 03:00**. Dënimi do të vuhet në një burg të sigurisë së zakonshme

Përsa i përket shpenzimeve procedurale, bazuar në nenin 393 paragrafi 1dhe në nenin 485 të K.Pr.Penale, shpenzimet proceduriale të fazës së hetimit në shumën prej 3.100 lekë si dhe shpenzimet gjyqësore në masën 200 lekë i ngarkohen të pandehurit.

PËR KËTO ARSYE,

Bazuar në nenet 379, 390, 406 dhe 485 të Kodit të Procedurës Penale nenit 22, 59 dhe 134/1 të Kodit Penal

V E N D O S I

1. Deklarimin fajtores të pandehures **Fredi Alizoti** i biri i Elmaz dhe i Ildize, dtl.01.01.1973, lindur dhe banues ne Fier, per kryerjen e vepres penale te “**Vjedhjes**” ne rrethane renduese te parashikuar nga neni

134/1 dhe 50 germa “ç” te K.Penal dhe ne baze te ketyre dispozitave denimin e tij me 3 (tre) vjet burgim.

2. Në zbatim të nenit 406 të K.pr.penale ulet 1/3 e dënimit dhe përfundimisht i pandehuri Fredi Alizoti denohet me 2 (dy)vjet burgim.
3. Vuajtja e këtij dënimi do të fillojë nga dita e arrestimit të tij më **dt06.12.2014 ora 03:00.** Dënimi do të vuhet në një burg të sigurisë së zakonshme
4. Shpenzimet procedurale në fazën e hetimeve paraprake në shumën 3.100 lekë si dhe shpenzimet gjyqësore në masën 200 lekë i ngarkohen të pandehurit.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga e nesërmja e shpalljes së tij, në Gjykatën e Apelit Vlorë.

U shpall në Fier, sot më dt.26.06.2015 !

SEKRETARE
ELVIRA TARTARAJ

GJYQTARE
OLKEDA MANELLARI